



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23. 05.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Genc Pollo – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i kalendarit të Komisionit për Integrimin European për periudhën 21 maj – 8 qershor 2018.

2. Të tjera.

Marrin pjesë:

Genc Pollo, Bledar Çuçi, Fatmir Velaj, Elisa Spiropali, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Sadri Abazi, Aldo Bumçi, Jorida Tabaku, Taulant Balla, Vangjel Dule,

Mungojnë:

Grida Shqina (Duma,), Klajda Gjoshaj, Viktor Tushaj

HAPET MBLEDHJA

Genc Pollo – Mirëdita, zonja dhe zotërinj!

Në mungesë të sistemit të mikrofonëve, që ende nuk funksionon, megjithëse presim që investimi i bërë të materializohet dhe të japë frytet e veta, fillojmë mbledhjen e komisionit.

Në rendin e ditës kemi dy pika:

1. Miratimin e Kalendarit të Komisionit për Integrimin European për periudhën 21 maj – 8 qershor 2018.

2. Të tjera.

Anëtarët e opozitës kanë shprehur shqetësimin për situatën e përgjithshme politike, në mënyrë të veçantë për rastin e ministrit të Brendshëm dhe kanë kërkuar që të diskutohet, sepse është me rëndësi të përgjithshme politike, publike, si dhe me impakt direkt në procesin e integritetit europian, me vëmendje të vendimmarrja e BE-së për hapjen e negociatave në fund të muajit qershor.

Kështu që, hapim diskutimet.

Fjalën e ka për procedurë nënkryetari i komisionit.

Bledar Çuçi – Faleminderit, kryetar!

Duke respektuar kërkesën e përfaqësuesve të opozitës, mendoj të procedojmë sipas Rregullores së Kuvendit. Pra, ta miratojmë kalendarin siç është ose me vërejtjet përkatëse dhe pastaj vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës “të tjera”, ku mund të diskutojmë lirisht edhe për situatën për të cilën ju doni të diskutoni, ashtu siç e kemi përcaktuar në axhendë.

Faleminderit!

Genc Pollo – Fjalën e ka për procedurë zoti Bumçi.

Aldo Bumçi - Besoj se jemi në komisionin e duhur për të diskutuar rreth integritetit europian dhe perspektivës së Shqipërisë për të hapur negociatat.

Dua të shpreh me keqardhje perspektivën e zymtë, që na u paraqit nga Kryeministri, për mundësinë e hapjes së negociatave.

Kryeministri Rama ishte për vizitë në Francë, një nga vendet që është jo i bindur për përgatitjen e Shqipërisë për të hapur negociatat. Këtë e tregoi edhe vizita e Kryeministrit në Francë vetëm për këtë çështje. Shqetësimi i Francës nuk është i ri dhe bazohet në 2-3 arsye të mëdha:

1. Numri i lartë i azilkërkuesve shqiptarë në Francë. Në fillim të këtij viti, sipas të dhënave të autoriteteve të larta franceze, numri i azilkërkuesve shqiptar në Francë ishte më i lartë se ai i sirianëve.

2. Problemet me fëmijët shqiptarë të braktisur në Francë dhe probleme që lidhen me kriminalitetin. Këto probleme të kahershme janë pasqyruar në vizitat e ministrit të Brendshëm francez në Shqipëri dhe vizitat e ministrave tanë në Francë.

Nga vizita dhe reagimi i Kryeministrit kuptuam që Franca vazhdon të mbetet ende skeptike për përgatitjen e Shqipërisë për hapjen e negociatave.

Një vend tjetër, që është shprehur kundër hapjes së negociatave, është Holanda. Edhe kjo nuk është e re. Besoj se të gjithë e dimë se në 2-3 vitet e fundit Holanda ka ngritur me të madhe problemin e krimit të organizuar shqiptar në Holandë, që merret me trafikun e kokainës dhe heroinës dhe me trafikimin e qenieve njerëzore nga Holanda në Angli. Problematika ishte kaq e rëndë sa që autoritetet holandeze bënë publike mundësinë e rikthimit të regjimit të vizave. Kaq e rëndë ishte situata sa kërcënuan Shqipërinë, që, nëse nuk do të trajtonte këto probleme, rrezikohej kthimi i regjimit të vizave. Pra, probleme reale të kahershme, që lidhen me azilkërkuesit, krimin e organizuar dhe trafiket.

Të njëjtat shqetësime janë shprehur nga Gjermania. Kryeministri ishte për vizitë në Gjermani. Në konferencën për shtyp me Kancelaren Merkel u tha publikisht se Shqipëria duhet të përmbushë parakushtet. Ky qëndrim i bërë publik nga vetë zonja Merkel, tregon se nuk janë përmbushur detyrat e shtëpisë, të vendosura nga Gjermania, vendi lider në BE.

Të njëjtat kushte kishte Gjermania edhe në vitin 2016: përveç 5 prioritetëve, zgjedhjet e lira dhe të ndershme, luftën kundër krimit, drogës dhe dekriminalizimin e politikës.

Duket se pas 2 vjetësh shqetësimet e gjermanëve të shprehura nga kancelarja Merkel janë të njëjta. Ajo tha, se ne nuk i kemi përmbushur parakushtet.

Këto kushte u nënvizuan dhe u bënë edhe më të qarta nga reporteri në Bundestag për Shqipërinë, Tomas Frei, i cili përmendi luftën kundër krimit dhe drogës. Ai tha se po ndiqnin me vëmendje jo vetëm çështjen e Saimir Tahirit, por tashmë, edhe të Fatmir Xhafajt. Bundestagu po ndjek me vëmendje problemin e ministrit të Brendshëm aktual, Fatmir Xhafajt.

Ka një shprehje: “Një pamje flet 1000 fjalë”. Fytyra e Kryeministrit në Samitin e Sofjes fliste 1000 fjalë. Asnjë kontakt, asnjë takim. Ajo shprehte se çfarë i kishin thënë partnerët: Shqipëria nuk ka përmbushur detyrat. Problemi kryesor i Europës, është krimi shqiptar, trafiku i drogave të forta, azilkërkuesit dhe fëmijët e braktisur. Për shkak të këtij

bilanci sot, në një kohë kur ne duhet t'i kishim hapur me kohë negociatat, pas 5 vjetësh, nuk hapen negociatat. Asnjë vend tjetër nuk është vonuar kaq shumë.

Serbia dhe Mali i Zi i kanë hapur negociatat 1 vit nga marrja e statusit të vendit kandidat. Kanë kaluar 5 vjet dhe kjo qeveri nuk i hap. Mesazhet kanë qenë të qarta.

Shqiptarët nuk e meritojnë këtë. Nuk ka komb më properëndimor sesa shqiptarët në Ballkan. Ata nuk e meritojnë një qeveri, që i lë jashtë dyerve të Europës se nuk i plotëson detyrat e shtëpisë, një qeveri që e kërcënon Europën me radikalizmin islamik, duke e njollosur kombin e vet, kur nuk ka asnjë rrezik të tillë, kur e kërcënon atë me Rusinë dhe me Turqinë dhe ia hedh fajin opozitës, në një kohë, kur fajin e ka vetë kjo qeveri e zhytur në krim dhe në drogë.

Shqiptarët nuk meritojnë që mbas kanabizimit 4-vjeçar të Shqipërisë, në një kohë kur ish-ministri i Brendshëm është në arrest shtëpie, edhe ministri i Brendshëm aktual duhet të ketë të njëjtat probleme.

Dëshiroj ta mbyll me deklaratën e Kryeministrit në një intervistë të dhënë para 2 ditësh: “Çështja e vëllait të Fatmir Xhafës është një çështje e vjetër. Ne e dinim këtë”.

Kur e dinte Kryeministri? Këtu ka një problem të rëndë moral, politik dhe ligjor. E paska ditur Kryeministri që vëllai i Fatmir Xhafajt është dënuar për trafik droge nga Gjykata e Lartë Italiane dhe ai prapë e bëri ministër të Brendshëm?

Ish-ministri Tahiri është në hetim për trafik droge dhe ai vë një tjetër ministër të Brendshëm me vëlla dënuar për trafik droge? Kur e dinte dhe kur e mësoi këtë? Dhe përsëri e emëroi ministër të Brendshëm?

E dyta, kur qenka informuar që vëllai i ministrit është dënuar me 7 vjet, a kishte detyrim të kontaktonte autoritetet italiane, që në Shqipëri gjendet një person i dënuar, i cili nuk ka kryer asnjë ditë burg?

Patjetër, për deklaratën e bërë para 2 ditësh, ka një përgjegjësi të rëndë politike, morale dhe ligjore. Kur e ka mësuar dhe përse nuk ka vepruar?

Dyert e Europës nuk mund të hapen, sepse ajo nuk është një hapësirë e krimit dhe e drogës, ku politika është e zhytur në krim, ashtu siç është zhytur në Shqipëri. Nuk ekziston një Europë e tillë. Ka vetëm një zgjidhje: qeveria e lidhur me krimin duhet të largohet, që shqiptarëve t'u rihapet edhe një herë perspektiva europiane.

Për 500 vjet Perandoria Osmane e mbajti këtë vend larg Europës. Për 50 vjet e izoloi komunizmi dhe për 5 vjet Edi Rama po ia mbyll dyert e Europës.

Faleminderit!

Genc Pollo – Faleminderit, zoti Bumçi!

Për problemin, që lidhet me ministrin e Brendshëm, ju kujtoj se ne kemi planifikuar që në dhjetor ta ftojmë në një dëgjese, por ai nuk është paraqitur. Nëse do të paraqitet para këtij komisioni, e mira është që ai të japë direkt personalisht përgjigje pyetjeve, që ju dhe shumë të tjerë ngrenë për figurën e tij dhe për Kryeministrin.

Bledar Çuçi – Kisha një sqarim për diçka që është e pasaktë, sepse është e vërtetë që e kemi ftuar. E verifikuam diku nga marsi nëse kishim lënë një datë me sekretarinë dhe sekretaria na konfirmoi se me ministrin e Brendshëm nuk kishin rënë dakord, se nuk kishim lënë në një datë. Lamë një datë bashkërisht dhe në datën që lamë bashkërisht u anulua mbledhja për shkak të axhendës së opozitës. Kështu, edhe për opinionin publik, nuk është arsyeja mosardhja e vetë ministrit, por arsyeja është se komisioni nuk ka rakorduar për të krijuar një hapësirë të mundshme për Ministrinë e Brendshme.

Megjithatë (se ne i kemi bërë 2 dëgjesa edhe me zëvendëskryeministren, edhe me ministren e Drejtësisë), e kemi vendosur në kalendar që të kemi edhe një dëgjese me ministrin e Brendshëm. Të vendosim datën kur ta shohim të arsyeshme dhe kështu duke thënë këtë, ju kërkoj zoti kryetar, miratimin e kalendarit, ku është edhe kjo pikë dhe më pas, të vijojmë me diskutimin e çështjeve të tjera sipas Rregullores.

Genc Pollo – Patjetër...

Bledar Çuçi – Faleminderit!

Genc Pollo – Unë e thashë, ne kemi në kalendar një dëgjese të planifikuar prej kohësh, por nuk komentova për arsyet pse nuk është bërë deri tani dhe, në këtë sens, fjalën e kanë kërkuar zonja Tabaku dhe zoti Dule.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Radhën e përcaktoj unë.

Jorida Tabaku – Zoti kryetar, në axhendën e ditës së nesërme të seancës plenare është vendosur një raport i Këshillit të Ministrave lidhur me gjetjet e rekomandimeve të raportit të Komisionit European për vitin 2018.

Për ato që e kanë lexuar dhe e kanë parë raportin, kjo është thjesht një përmbledhje e progresraportit, e raportit të vendit, të publikuar pak javë më parë, ku nuk shoh asnjë masë, asnjë plan nga ana e qeverisë, asnjë strategji se çfarë do të ndodhë dhe çfarë ka në mendje qeveria të bëjë për çështjen që e diskutojmë prej pothuajse 4-5 muajsh, për hapjen e negociatave, si dhe asnjë dokument strategjik lidhur me grupin e negocimit, për strukturat e negocimit e kështu me radhë.

Partia Demokratike ka që prej shtatorit, kur ky komision u mbledh, që kërkon, së pari, një dokument të tillë, pra vizionin e qeverisë në periudhën afatmesme dhe afatgjatë për negociatat.

Së dyti, ka kërkuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju thatë që në dhjetor, por, në fakt, unë besoj se kemi që në shtator kur u mbledhëm që kërkojmë që të tre ministrat, të cilët kanë lidhje me prioritetet, të vijnë të raportojnë këtu.

Mua më duket qesharake që ministri, i cili mbulon dy prioritetet bazë: luftën ndaj krimit të organizuar dhe drogës, të mos gjejë në dhjetë muaj dy orë kohë për të ardhur dhe për të diskutuar në Komisionin për Integrimin Europian.

Ne mund të ndahemi në shumë gjëra bashkë. Ka ardhur ministri për Europën dhe Punët me Jashtë këtu dhe jemi ndarë në shumë gjëra bashkë, edhe kur erdhi ministrja e Drejtësisë, madje edhe kur erdhi zëvendëskryeministrja, por nuk do të thotë të biem dakord për të gjitha gjërat.

E rëndësishme është se ato erdhën dhe raportuan, ndërkohë që nga ministri i Brendshëm... Unë nuk besoj se ai ka shkuar në ndonjë komision parlamentar. Ne këtu nuk kemi dëgjuar një raport për masat që po merr qeveria për krimin e organizuar dhe luftën ndaj drogës (të dyja këto janë prioritetet bazë) dhe Komisioni për Integrimin Europian nuk besoj se do të kishte punë tjetër, përveçse të diskutojë për pesë prioritetet.

Në mandatin e kaluar u propozua një projektrezolutë nga Partia Demokratike, e cila shprehte angazhimin maksimal të të dyja palëve për plotësimin e të pesë prioritetëve dhe për miratimin e çdo ligji të nevojshëm për marrjen e statusit të vendit kandidat dhe për hapjen e negociatave, duke shprehur vullnetin e opozitës. Por opozita vetëm kaq mund të bëjë, të shprehë vullnetin. Në qoftë se vullneti politik mungon nga qeveria, dhe duket qartazi se mungon nga qeveria, që nga dokumenti që kanë sjellë këtu deri te fakti se nuk ka asnjë dokument strategjik qeveria shqiptare. Në qershor ne presim një datë shumë të rëndësishme, ndërkohë qeveria duket sikur është dorëzuar komplet, as ka përgatitur ndonjë material, as na ka sjellë ne këtu një strategji. Jemi mbledhur në Këshillin e Integritimit, kemi diskutuar, sigurisht rreth informacioneve që kishim, dhe nuk kemi parë asnjë dokument serioz të qeverisë shqiptare ku të tregojë se është gati për këtë proces dhe është gati për hapjen e negociatave.

Qartësisht kur këtë gjë nuk e shohim të shkruar në shkresa, kur këtë nuk e shohim në dokumente, kur këtë nuk e shohim në një dokument strategjik, sigurisht që përkthehet në mungesë vullneti. Por, nga ana tjetër, çfarë të shkruajë qeveria në këto dokumente

strategjike? Çfarë të shkruajë për krimin e organizuar dhe për luftën ndaj drogës? Ne kemi raportet e Europol-it, Departamentit Amerikan të Shtetit, kemi edhe progresraportin e Komisionit European (raportin e vendit, të publikuar pak javë më parë), që e tregojnë qartësisht situatën këtu në Shqipëri.

Me gjithë dëshirën e mirë që ne kemi dhe me gjithë mbështetjen që opozita po i ofron këtij procesi kudo, si jashtë dhe këtu në Shqipëri, është e pamundur që ne të luajmë rolin e qeverisë; është e pamundur që ne të bëjmë atë çfarë nuk bën dot qeveria.

Në qoftë se qeveria shqiptare na përkthen progresraportin e vendit dhe na e sjell këtu si një dokument zyrtar të qeverisë shqiptare, unë nuk di çfarë të them dhe nuk di se si mund ta bëjë opozita rolin e saj në këtë proces, kur nuk e bën qeveria.

Mua më duket qesharake. Më duket mungesë dëshire, mungesë vullneti. Unë e kuptoj që rezultatet si në luftën ndaj korrupsionit, ashtu edhe ndaj krimit të organizuar dhe drogës, janë ato që janë, por Shqipëria është, fatkeqësisht, peng i krimit, është peng i atyre që sot organizojnë trafikun e drogës.

Unë e kuptoj që qeveria është dorëzuar, por ne, si opozitë, do të vazhdojmë ta luajmë rolin tonë deri në fund dhe do të kërkojmë nga qeveria që, së pari, të mos ta bëjë këtë për veten, por ta bëjë për qytetarët shqiptarë, të cilët e presin prej pesë vjetësh këtë proces.

Faleminderit, zoti Pollo!

Genc Pollo – Faleminderit, zonja Tabaku, por kam një vërejtje për sa thatë!

Shoh se në pikën 3 të rendit të ditës së seancës plenare, që mbahet nesër, është pikërisht raporti i Këshillit të Ministrave (gjetjet dhe rekomandimet e progresraportit të Komisionit të European) për Shqipërinë. Unë vërej se ky raport nuk ka kaluar në Komisionin për Integrimin European, pra nga komisioni ynë, çka është normë dhe praktikë e traditës dhe e Rregullores, në kuptimin se duhet të ishte shqyrtuar në komision dhe t'i kalohej më pas seancës plenare.

Kjo është një shkelje tjetër, përveç problemeve të mëdha që kemi diskutuar dhe i trajtuam edhe sot për mënyrën e funksionimit të Kuvendit, si dhe për një çështje të tillë që, për nga natyra e saj, do të ftonte një korrektesë më të lartë në përputhje me Rregulloren tonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e kishte kërkuar zoti Dule.

Taulant Balla – Ta marrim fjalën me radhë, një nga maxhoranca, një nga opozita...?

Genc Pollo – Do të përpiqemi ta balancojmë.

Dakord.

Fjalën e ka zoti Dule.

Vangjel Dule – Faleminderit, zoti kryetar!

Nuk besoj se në mesin tonë është ndokush që mund të....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në lidhje me procesin e integritetit.

Një shikim i thjeshtë tregon se një vend që ka pasur mundësi krahasimisht shumë më të mëdha sesa vendet e tjera të rajonit, nuk ka arritur ende të çelë negociatat, me gjithçka shoqërohet një zhvillim i tillë dhe me pasojat negative që ajo ka në të gjitha aspektet e jetës së vendit.

Nuk duhet të harrojmë se vonesat në marrjen e statusit të vendit kandidat për disa vjet me radhë u shkaktuan edhe nga qëndrimi i opozitës së atëhershme në lidhje me votimin e projektligjeve për të cilat insistonte Bashkimi Europian. Nuk duhet të harrojmë edhe arsyen se në atë kohë opozita, maxhoranca e sotme, nuk i votonte tri ligjet, sepse ishte e pakënaqur me zhvillimet zgjedhore në këshillin e qarkut të Fierit, pra kreu i një qarku ishte më i rëndësishëm se procesi i integritetit të vendit.

Kalojmë në situatën aktuale. Shtrohet pyetja në shumë nivele: në nivel politik, në nivel gazetarësh dhe në nivel qytetarësh e të shoqërisë. Çfarë po ndodh?! Komisioni i Bashkimit Europian ka dhënë rekomandim pozitiv për çeljen e negociatave, veçse dëgjojmë se vende të rëndësishme të BE-së, njëri pas tjetrit, pozicionohen duke thënë se ende nuk kanë vendosur nëse do të jenë pro apo kundër çeljes së negociatave. Në pamje të parë duket e paimpërshtueshme, po si është realiteti?! Të gjithë e dinë se Komisioni i Bashkimit Europian merret me aspektin teknokratik të procesit të integritetit dhe me procesin politik merren qeveritë e vendeve anëtare. Këtu është për t'u thënë se, edhe me kontributin e opozitës, parlamenti i ka kryer detyrat e tij. Nuk ka ligje të cilat janë pending, pra që janë në pritje të miratimit, dhe pengesë për to bëhet opozita. Është kriteri politik që i bën skeptike këto vende; është qeverisja e vendit; është Kryeministri i vendit, aty qëndron pengesa pse vendet anëtare nuk janë ende në të njëjtën linjë në qëndrimin e tyre për rekomandimin e Komisionit të Bashkimit Europian.

Por më lejoni të bëj një hipotezë pozitive: në qershor marrim lajmin e shumëpritur të çeljes së negociatave. Çfarë janë negociatat dhe çfarë synojnë ato?! Negociatat synojnë nënshkrimin e një traktati anëtarësimi, të një marrëveshjeje të vendit tonë me BE-në, me interesat e tij në tërësi dhe me interesat e çdo vendi anëtar të BE-së në veçanti. Ky është një proces i vështirë negociues. Ju mendoj se nëse ky hap i shumë pritur ndodh në qershor, ne kemi një kryeministër si negociator dhe një qeveri shoqëruese të aftë për t'u shërbyer interesave të vendit në procesin e negociimit?! Ju mendoj se kur kryeministrat, ministrat e

vendeve të tjera, strukturat e Bashkimit European do të kenë përballë kryeministrin e një qeverie, së cilës i dalin ministrat njëri pas tjetrit të implikuar në trafikun e drogës, një kryeministër, i cili nuk ka garantuar proces zgjedhor të ndershtëm gjatë zgjedhjeve të shkuara, kur në sondazhet e organizuara nga vetë Komisioni i Bashkimit European 20% e bashkëqytetarëve tanë pranojnë se janë paguar për të dhënë votën e tyre në favor të Partisë Socialiste?! Ju mendoni se të gjitha ata që do të kenë përballë këtë Kryeministër, do ta marrin seriozisht dhe do të negociojnë në favor të interesave të vendit me këtë proces të vështirë dhe të ndërlikuar?

Zotërinj, a e kuptoni se trajektorja e kësaj qeverie është e parashkruar?! Kjo është një trajektore në rënie drastike. Ku dallohet politikani i përgjegjshëm nga ai i papërgjegjshëm?! Politikani i përgjegjshëm mban frymën dhe thotë: “Deri këtu ishte mandati im politik. Nuk marr me vete edhe fatin e vendit”. Te qëndrimi i politikanit të papërgjegjshëm klasifikohet Kryeministri juaj, kreu juaj. E kuptoj pozitën tuaj të vështirë. Shumica prej jush janë të rinj dhe kanë investuar ëndrrat e tyre, por, fatkeqësisht, kjo ju ndodhi, distancohuni prej tij! Ai do të marrë me vete edhe vendin, edhe shoqërinë. Kuptojeni! Ndërpritjani këtë trajektore, sepse është trajektore fatale! Shumë nga ju keni studiuar edhe në universitete të huaja, shikoni shembujt, shikoni precedentët. Është gjynah që ky Kryeministër të dëmtojë interesa strategjike, të ardhmen e vendit, vetëm e vetëm për karrigen e tij, shpëtim për të cilën nuk ka. Mund të ketë një zgjatje 3, 6 apo 9 muaj më tepër në pushtet, por a ia vlen ky 3, 6 apo 9-mujor të vihet në balancë me interesa të tilla strategjike? Prandaj, ju lutem, në këto momente të vështira merren edhe vendime të vështira. Do të shikoni që të shtunën do t’i keni të gjithë shqiptarët kundër; keni demokratë dhe socialistë. Është fenomen tipik i nervozizmit dhe i dëshpërimit tuaj nënqeshja ironike, të cilën e shikoj këtu brenda dhe në medie. Është fenomen tipik! Shikojini dhe analizojini! Jeni të aftë për ta bërë. Janë dëshmi të gjendjes në të cilën jeni.

Prandaj, zoti kryetar, dua ta përfundoj, duke u kapur edhe pas faktit që ju përmendët. E kuptoni seriozitetin e kësaj qeverie që vjen në seancë plenare më analizën e saj të raportit të Komisionit të Bashkimit European, pa u konsultuar paraprakisht me Komisionin, i cili është kryesisht përgjegjës për çështjen e integritetit dhe për këta kolegë të nderuar, që ua paska marr mendimin, u dha një vlerësim, që të diskutohej në komisionin ku bëjnë pjesë, aq më tepër për ne, pjesëtarët e opozitës.

Faleminderit!

Genc Pollo – Faleminderit, zoti Dule!

Në fakt, raporti i Këshillit të Ministrave, që përmendët dhe që përmenda edhe unë, është parashikuar në kalendarin që shtrohet për miratim këtë muaj. Megjithatë, kjo është gjendja.

Urdhëroni!

Taulant Balla – Faleminderit!

Mund të ketë shumë njerëz që kanë vite në parlament, por askujt nuk do t'ia merrja për keq, me përjashtim të koleges Tabaku, e cila bashkë me mua dhe me zonjën Bregu, jaemi bashkëhartues të ligjit, që dikur quhej ligji “Zela”, sot, kur e kemi miratuar së bashku, mund të quhet “Bregu-Tabaku-Balla”, i cili, lidhur me raportimin në Kuvend të qeverisë sa herë që ka një progresraport, ka një nen, pra neni 18 “Raportimi në Kuvend”, dhe ka paragrafin 2, që e ka të sanksionuar që raportimi i qeverisë bëhet direkt në sallë plenare dhe nuk bëhet në asnjë komision. “Këshilli i Ministrave, jo më vonë se 3 javë nga publikimi i raportit të progresit të Komisionit European, raporton në Kuvend për të gjithë rekomandimet dhe situatën aktuale të zhvillimit”. Kjo është një praktikë pune, që ne ia kemi adresuar tërësisht sallës plenare, po të kemi parasysh atë që kemi rënë dakord para 3 vjetësh, kur e kemi bërë së bashku për t'i dhënë Kuvendit të gjithë autoritetin që i ka dhënë edhe Kushtetuta, në lidhshimin e procesit të integritetit european. Pra, gjithë këtë pledoari për histori, për shkelje Rregulloreje e të tjera me radhë, tërhiqeni mbrapsht, sepse nuk ju qëndron aspak.

Së dyti, ka një diskutim për këtë çështje, që mund të ishte bërë në Konferencën e Kryetarëve, që nuk ka ndodhur. Konferenca e Kryetarëve është autoriteti i vetëm që ka Kuvendi i Shqipërisë me Rregullore, për të përcaktuar modalitetin edhe të zhvillimit të një raportimi, por ju nuk jeni.

E dashur zonja Tabaku, të mirëkuptoj për kontributin tuaj të vyer, në kuadër të lobimit që duhet të zhvillonim së bashku, për t'i bërë mirë Shqipërisë, por mjafton të krahasosh fjalët e tua, me fjalët e Lulzim Bashës përballë delegacionit të parlamentit të Holandës, për të kuptuar diferencat e mëdha në botëkuptimin që ti ke me kryetarin e partisë tënde për sa i përket lobingut.

Jorida Tabaku – Shyqyr që ishte zoti Pollo dhe Elisa, sepse...

Taulant Balla – Ti duhesh falënderuar për gjithçka bën mirë aq sa mundesh me tryezat me të huajt, por jo Lulzimi!

Jorida Tabaku – Taulant, ky diversioni për dy lekë nuk shkon...

Taulant Balla – Të lutem, unë nuk të ndërpreva aspak!

Tjetra që ka të bëjë me gjithë këtë histori, edhe këta të shkretët që janë të detyruar të rrinë në këmbë, në të gjitha komisionet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Mos u thuaj të shkretë, sepse janë të gjithë kolegë, njësoj si ne, deputetë. Nuk janë të shkretë!

Taulant Balla - Kuvendi i Shqipërisë do ta vazhdojë punën e tij në mënyrë shumë normale. Kuvendi i Shqipërisë është duke e bërë punë e tij në mënyrë shumë normale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ftesa ime për ju është që nesër ju të merrni pjesë normalisht në raportimin që bën qeveria, sipas Rregullores, për ata që nuk e dinë, nëse ju keni dëshirë që të zhvillojmë një debat për këtë çështje, jeni tërësisht të mirëpritur të depozitohet së bashku kërkesën, nëse e doni debatin me kohë të përcaktuar, nëse e doni debatin pa kohë të përcaktuar, por e rëndësishme është që të mblidhemi dhe të diskutojmë, sikurse na ka mandatuar sovranin secili prej nesh. Populli nuk ka çuar njerëz në parlament për të prishur punën e komisioneve apo të Kuvendit, përkundrazi populli na ka çuar në Kuvend për të diskutuar, për të pasur mendime të kundërta, por kur vjen puna dhe çështja tek integrimi evropian, nuk ka ndodhur, në asnjë nga vendet, që sot janë anëtare të Bashkimit Evropian, kur janë gjendur në fazën ku jemi ne aktualisht, të kishte një opozitë, si kjo që ne kemi sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Spaho, e di fare mirë që gjithë kjo histori e sajuar ndaj Fatmir Xhafës, duke kaluar ditët, po sqarohet fare mirë.

Klevis Balliu - Si ajo e Saimirit?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Taulant Balla - Pusho se nuk po flas me ty fare!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti shko merru me tenderët e ilaçeve! Mbylle se po flas unë! Kur flas unë, këtu nuk flet njeri, kur të mbaroj unë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të flas për Fatmir Xhafajn, sepse Fatmir Xhafaj, po u godet atje ku ju dhemb më shumë juve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të jeni të sigurt se dhimbja do të vazhdojë derisa të bëhet e padurueshme. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Klevis Balliu – Ashtu si me Saimirin, që e mbrojtët deri në fund.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Taulant Balla – Djali mos bëj zhurmuesin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e rëndësishme që Shqiptarët po e kuptojnë fare mirë, që historia me “Babalen” është një shpikje, që ka për regjisor një person, edhe Luli e di këtë punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, Sali Ramë Berisha quhet regjisor i kësaj historie. Ju i dini dhimbjet që ka Saliu këto ditë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa për vëllanë, tregon që sa kot ke qenë ti ministër Drejtësie, sepse në vitet 2005-2006-2007 ke qenë ministër Drejtësie. A ka pasur urdhër ekstradimi gjatë kohës tënde?

Aldo Bumçi- Gjykata e Lartë italiane e ka dënuar.

Taulant Balla – O ministër i Drejtësisë, që raportoje te Shkëlzeni. Ja ky, e mbani mend këtë, që raportonte me letër te Shkëlzeni dhe i thoshte: “T’i dërgohet porosia”?

Aldo Bumçi – E ka dënuar Gjykata e Lartë italiane, nuk e ka dënuar opozita shqiptare.

Taulant Balla - Aldo, ke bërë gjithë atë shkollë, mos bëj zhurmë! Të njëjtën procedurë që ndoqe ti për Izet Haxhinë, për garancitë që i dhe shtetit turk për të bërë ekstradimin..

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, ti pse nuk i njoftove? Ju e dini fare mirë..

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi folur ndryshe me Fahriun për këtë punë, s’kemi folur kështu dhe kemi rënë dakord për këtë. Me Fahriun kemi rënë dakord për gjëra të tjera, s’kemi rënë për këtë. I thamë që duhet të bësh pak zhurmë, që të marrë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aldo, është shumë e rëndësishme kjo.

Aldo Bumçi – Është gjykatë italiane.

Taulant Balla – Ju nuk po më lini. Unë jam në komisionin ku jam anëtar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem ore, Babalja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos bëni zhurmë, sepse ne po ju bëjmë edhe reklamë dhe po bëjmë thirrje për në piknikun me Lulin në datën 26. “Dj. Babale & others”.

Bardh Spahia– Ku e keni kampionin e qeverisë suaj?

Taulant Balla – Kampioni ju ka shkaktuar aq shumë dhimbje, sa që nga dhimbjet keni filluar të bërtisni aq keq, sa nuk dini se ç'keni bërë. Partia e idealeve të dhjetorit ka degraduar në një parti, e cila sot ka për lider Babalen. Sa dështoi Luli, morët Babalen. Nëse doni ta zëvendësoni Lulin me Babalen, ky është problem.

Të kthehemi te historia që kemi nesër. Anëtar...

(Ndërhyrja pa mikrofon)

Taulant Balla – Babalja është heroi i Partisë Demokratike në kohën që kjo parti është pa lider.

Bardh Spahia – Pyet Fatmirin se mos ka folur me Babalen dhe mos e njeh më mirë se ne, ndoshta ka folur vëllai i tij, vëlla e ka, nuk e ka komshi.

Taulant Balla – E ke gabim, sepse kështu si shkoi kjo puna juaj, është për të qarë hallin. Luli tha: “E bëri Babalja” Babalja tha: “E bëri gazetari” gazetari tha: “E bëri PD-ja”. Kjo punë ngeli jetim në prehrin e Saliut, e shoh unë. Siç jua thashë edhe dje, Saliu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S'po më lënë të flas, ndërprit zhurmuesin, që i solle...

Genc Pollo – Të qëndrojmë në temë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Taulant Balla – Në qoftë se ngel e vërteta ta thuash ti, e vërteta nuk quhet më e vërtetë.

Për sa i përket asaj që kemi nesër, Komisioni i Integritetit Europian, të paktën ju anëtarët e komisionit nga opozita, duhet të tregoni seriozitet në marrëdhënien që keni, qoftë me ligjin për rolin e Kuvendit të Shqipërisë në integrimin europian, qoftë edhe për rëndësinë që opozita duhet të ketë tashmë me vepra, jo me fjalë... A mund t'ju them troç? Ju nuk keni kontribuar fare në këtë proces të rëndësishëm, në komunikimin që duhet të bënim së bashku. Unë dhe ti, Joridë, duhet të ishim të dy së bashku në Holandë ose në Gjermani. Mos u tremb, se të kam kolege.

Jorida Tabaku – Unë thashë që ka shkuar Fatmiri atje dhe na përfaqëson shumë mirë, për çfarë duhet...

Taulant Balla – Duhet të ishim edhe ne të dy bashkë. Ashtu si në vitin 2008, kur Saliu i vuri flakën Gërdecit, ne ishim përkrah...

Jorida Tabaku – Të mos fillojmë me Griseldën tani, se cilët ishin autorët e Griseldës. Të mos fillojmë me ato që ndodhën në vitin 2011.

Taulant Balla- Jorida, mos u merr ti me këtë pjesë, sepse ti je një grua.

Genc Pollo – Mos u merrni me njëri-tjetrin.

Taulant Balla – Mos u merr me gratë ti, mos u bëj si Albana, sepse ti je ndryshe nga Albana. Albana është shembulli më i keq i grave në politikë kundër grave.

Genc Pollo- Një minutë, sepse këta janë terma të papranueshëm ndaj kolegëve.

Taulant Balla – Ndërmjet Albanës dhe Joridës, zgjedh Joridën.

Genc Pollo- Dakord, por mënyra se si po drejtohet, nuk mund të jetë në këtë mënyrë.

Taulant Balla – A mund ta bëj propozimin?

Genc Pollo- Në këtë rast, ju duhet t'i kërkonti ndjesë koleges.

Taulant Balla – Zoti Pollo, nuk i kërkoj ndjesë, sepse një kryetare komisioni që merr vesh se nënkryetarja e komisionit është e sëmurë dhe gënjen të gjithë opinionin publik, duke thënë se këta po bojkotojnë mbledhjen e komisionit, vetëm Albana mund ta bëjë këtë, por është çështje e Albanës, sepse kështu e ka zgjedhur të mbijetojë.

Genc Pollo- Kjo është çështje e një komisioni tjetër dhe...

Taulant Balla – Për sa i përket kalendarit të Komisionit të Integritetit Europian, 21 maj deri më 8 qershor, ju propozoni që të përfshihet raporti i Komisionit Europian dhe sigurisht duhet të bëjmë një listë dëgjësash me të gjitha ministrinë. Unë propozoj të gjitha ministrinë të vijnë në Komisionin e Integritetit.

Për sa i përket raportit të Këshillit të Ministrave, në përgjigje të rekomandimit, jua shpjegova se neni 18, pika 2, ku në koncept ne kemi dhënë idenë që raporti të jetë drejtpërsëdrejti në Kuvend. Duhet ta keni parasysh që kemi edhe dy raportime të tjera: raportin e Këshillit Kombëtar të Integritetit, që...

Genc Pollo – Që ka kaluar.

Taulant Balla – Jo, duhet ta fusim për raportim në seancë plenare. E kemi edhe atë një detyrim. Dhe përveç...

Genc Pollo – Të Këshillit Kombëtar të Integritetit.

Taulant Balla – Të Këshillit Kombëtar të Integritetit.

Pra, edhe Këshilli Kombëtar i Integritetit e ka detyrë specifike raportimin në Kuvend, sikurse të gjitha institucionet e tjera. Kështu që edhe këtë duhet ta planifikojmë dhe të biem dakord me njëri-tjetrin për të bërë edhe një raport të përbashkët, po të kemi parasysh se Këshilli Kombëtar i Integritetit, sigurisht, drejtohet nga opozita, por dhe ne kemi rolin tonë kontributiv në drejtimin e këtij komisioni.

Faleminderit!

Genc Pollo – Faleminderit!

Një sqarim nga ana ime.

Pastaj zonja Tabaku kërkon të sqarojë shkurt diçka.

Fjalën e kishte zonja Vokshi dhe më pas zoti Spaho, lidhur me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, një balancë duhet të ruhet.

...çfarë është Kuvendi dhe si trajtohet në ligj. Një sqarim të përgjithshëm, se besoj se është detyra e kryetarit të qëndrojë për rregullat.

Shumë institucione jashtë Kuvendit raportojnë në Kuvend. Këshilli i Ministrave sjell projektligje, projektakte dhe raporte, Presidenti i Republikës sjell dekrete, të tjerët sjellin raporte, por kjo nuk do të thotë (dhe për këtë nuk mjafton të kesh përvojë të gjatë, mjaftojnë një ose dy javë për ta kuptuar në qoftë se e ke vëmendjen) të shkojnë direkt në plenare. Kuvendi organizohet me komisione dhe komisionet, sipas fushës që mbulojnë, trajtojnë çdo material që vjen në Kuvend, me përjashtim të rasteve të urgjencës dhe dekreteve të Presidentit të Republikës, sipas Kushtetutës.

Është e pakuptueshme, është kundër Rregullores dhe kundër traditës që kemi, që një raport për integrimin europian, që vjen nga Kryeministria, të mos shqyrtohet nga komisionet e ndryshme, përfshirë edhe komisionin tonë si i pari. Këtë koment kisha unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk thotë ligji të shkojë në plenare. Është parësi? Dakord, por jo të shkojë direkt në plenare. Kjo është e pavend.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku - Nuk ka shkuar asnjëherë në plenare.

Genc Pollo – Pa kaluar në komisione përkatëse?

Jorida Tabaku – Jo.

Genc Pollo – Po pra, atë po them.

Jorida Tabaku – Raporti i Këshillit të Ministrave nuk ka shkuar asnjëherë në plenare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Genc Pollo – Është anapulla.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Vjet nuk ka pasur raport progresi. Në 2016-n ka pasur.

Taulant Balla – Brenda dy muajve të parë të vitit del raporti.

Jorida Tabaku – Po nuk ka pasur, pra!

Taulant Balla – Këtë ligj e kemi bërë bashkë.

Genc Pollo – Kolegë dhe kolege, mbas këtij sqarimi (e saktësojmë edhe gjetiu), fjalën e ka zonja Tabaku për një përgjigje shkurt. Më pas fjalën e ka zonja Vokshi.

Jorida Tabaku – Unë kam dy fjali, shkurt, pa dashur të përsëris veten me ato që thashë.

Opozita do të kishte dashur shumë ta miratonte këtë rezolutë, që ka ardhur e propozuar nga kolegët e maxhorancës, por kjo rezolutë nuk përmend luftën ndaj krimit të organizuar dhe drogës. Kjo rezolutë nuk përmend situatën që përmendet në të gjitha raportet ndërkombëtare. Kjo rezolutë nuk përmend, absolutisht, asnjë nga elementet që janë, si në raportin e progresit, ashtu edhe në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit, që paratë e krimit dhe të drogës kanë penetruar në ekonomi, që Shqipëria po bëhet parajsë për pastrimin e parave. Këtu nuk është asgjë. Për çfarë do të shprehë vullnet qeveria, kur këtu nuk ka një plan masash?!

Që nga kryetari i opozitës dhe çdo deputet i opozitës, i Partisë Demokratike, përfshirë edhe mua, kudo ku kemi pasur mundësi kemi lobuar me partnerët ndërkombëtarë për hapjen e negociatave, jo se qeveria e meriton, jo se qeveria i ka zbatuar të gjithë detyrat, por qytetarët shqiptarë e meritonin këtu e 5 vjet të shkuar, thjesht për të nisur një proces.

Hapja e negociatave nuk është një destinacion përfundimtar. Thjesht nis një proces që ne mendojmë se institucionet shqiptare duhet ta nisin. Ky ka qenë zëri zyrtar i opozitës. Ky ka qenë qëndrimi zyrtar i opozitës.

Por nuk mund të mbylлим, as sytë, as veshët, përballë krimit në qeveri, krimit në parlament dhe drogës, që sot po bëhet, jo problem kombëtar, por problem ndërkombëtar dhe po cenon edhe sigurinë kombëtare të Shqipërisë.

Faleminderit!

Bledar Çuçi – Për procedurë...

Genc Pollo – Për procedurë, 30 sekonda.

Bledar Çuçi – Në vijim të asaj që tha zonja Tabaku, se do ta votonim me dëshirë këtë rezolutë, por nuk përmendet fare lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit...

Ju kujtoj, zonja Tabaku, se pika 12 e rezolutës thotë: “I kërkon qeverisë të angazhohet në vazhdimësi për marrjen e të gjitha masave për plotësimin e 5 prioritetëve kyçe për hapjen e negociatave për anëtarësimin, forcimin e shtetit të së drejtës dhe parime të demokracisë funksionale, veçanërisht për (dhe janë me radhë) mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; mbrojtjen e garancive kushtetuese të nëpunësve të administratës publike; konsolidimin dhe mbrojtjen e autonomisë vendore; luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit (pra, është një thirrje e drejtpërdrejtë, që pasqyrohet në rezolutë); mbrojtjen e lirisë ekonomike dhe stabilitetit ekonomik të vendit dhe zbatimin e shpejtë dhe me efikasitet të reformave të ndërmarra”.

Gjuha e rezolutave është kjo. Tani, këtu biem dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është shumë qartë e evidentuar se ku duhet të fokusohet puna e qeverisë, në mënyrë që të kemi një integrim sa më të shpejtë të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Në qoftë se e rilexojmë edhe një herë me këtë sy, ju ftoj ta miratojmë bashkërisht rezolutën, sipas premtimit që ju bëtë.

Genc Pollo - Është e qartë, por kam përshtypjen se është edhe pak e sheqerosur, me sa dëgjoj. Megjithatë, kur diskutohet në thelb...

Zonja Vokshi, ju lutem!

Albana Vokshi – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, doja t'i thosha kolegut Balla se jeni bërë për të ardhur keq, për mënyrën si flisni, për mënyrën si sulmoni opozitën, gazetarët dhe çdo njeri që nuk është në një mendje me ju. Në fakt, është e paprecedentë.

Nëse ju thoni se unë jam shembulli i gruas në politikë, që është kundër grave, unë dua të kujtoj se rezoluta për dhunën ndaj grave ishte propozim imi, për t'i mbrojtur edhe nga dhuna verbale që ju, edhe si kryetar i grupit të maxhorancës, përdorët sot me mua apo përdorni ndaj gazetarëve, apo ndaj çdokujt, çdo gruajë, madje edhe ndaj deputeteve tuaja.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe ndaj deputeteve tuaja e përdorni këtë dhunë.

Rezolutën kundër dhunës së grave e keni miratuar me unanimitet dhe ti i pari po e shkel me të dyja këmbët.

Mjaft me këto sulme! Lërimi! Flisni politikisht! Tregojuni qytetarëve atë që po ndodh realisht! Me sulme ndaj grave nuk besoj të fitoni ndonjë pikë, për më tepër.

E dyta, në cilin nen të Rregullores është që nuk bëhet mbledhja kur nënkryetarja është sëmurë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në cilin nen të Rregullores thuhet se mbledhja e parashikuar e komisionit nuk do të bëhet, meqenëse është sëmurë një deputet i maxhorancës?

Në kalendar ka qenë në orën 10:00. I ke mbledhur te zyra jote dhe nuk i ke lënë deputetët të vijnë, sepse kanë qenë në korridore, për një arsye të vetme, sepse ti do të pengosh zërin e opozitës. Po bëni censurë totale.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po mohoni zërin e opozitës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Menduat që ne nuk do ta zhvillonim mbledhjen. Menduat që ne, nëse ju nuk do të vinit, nuk do t'u jepnim mundësi deputetëve që kishin ardhur, për të treguar atë që po ndodh tani në Shqipëri.

Nëse ka një pengesë në rrugën drejt Bashkimit European, jeni ju. Ju po e pengoni. Ka qenë edhe në rekomandimet e mbledhjes së fundit të SAP-sit. Ka qenë roli i opozitës. Çfarë bëni? Nuk sillni ministrat, bojkotoni komisionet. A keni parë ju një maxhorancë që bojkoton komisionet? Nuk ka, nuk ndodh.

Ti u jep urdhër të bojkotojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ndodh.

Edhe këtë mbledhje...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fate.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pse nuk erdhe dje në mbledhje? Edhe këtë mbledhje mund ta kishim bërë te komisioni im. Bojkotoni komisionin tim! Hajdeni, jua jap. Atje keni edhe sistemin e zërit, mund të flasim lirshëm, madje.

Nuk ndodh. Mos censuroni!

Çfarë po bëni? Po sulmoni gazetarët. Po sulmoni opozitën. 7 orë në ditë kemi *live* komandantin tek ERTV-ja. Këshillojeni! Është bërë më keq se Chavez dhe Maduro. 7 orë në ditë *live* me Tërmetin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E tmerrshme. Na nxori mallin e kohës së Enver Hoxhës. Si Shefqet Peçi, që thoshte: “Rroftë komandanti Enver Hoxha”, edhe Shefqeti dje tha: “Rroftë komandanti, shoku Edi Rama”.

Nuk po lini hapësira. Pse? Ti, Taulant, e di më mirë, edhe punën e tenderëve, edhe të ilaçeve, edhe të koncesioneve, edhe të drogës e di shumë mirë, edhe të trafikut e di shumë mirë, edhe të vëllait të ministrit e di shumë mirë, edhe të kushërinjve të ish-ministrit e di shumë mirë, edhe si kalojnë, me çfarë makine, me çfarë pasaporte, diplomatike apo jo, e di shumë mirë. Tregojua qytetarëve shqiptarë! Mos hajde këtu të thuash “po gënjen”!

Në fakt, kam edhe diçka tjetër që dua të ngre pasi jemi ligjvënës. Shkova edhe te Komisioni i Ligjeve, por në mënyrë të paprecedentë, zoti Manja, kolegu im, më mohoi të drejtën e fjalës. Nuk ka ndodhur ndonjëherë që një deputet, bazuar në pikën 4 të nenin 32 të Rregullores, të kërkojë fjalën për procedurë dhe kryetari t’ia mohojë. Është e paprecedentë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atje isha, meqenëse ishin edhe përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të EURALIUS-it, për të folur për nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale. Jemi ligjvënës dhe fare mirë mund të diskutojmë si u trafikua ligji. Si mundet që kryetari i komisionit nuk ruajti dot procesverbalin nga zyra deri te seanca plenare, por e falsifikoi ligjin për të mbrojtur familjarët, për të mbrojtur vëllanë? Sigurisht, kryetari ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Aty isha, sepse ishte EURALIUS-i. Aty isha për ta dëgjuar, por, sigurisht, na u mohua e drejta e fjalës.

Një nga kriteret është: të gjithë të barabartë para ligjit. Ku jemi të barabartë para ligjit, kur ligji bëhet ndryshe për vëllanë dhe ndryshe për 4 kuksianët?

Atëherë, kështu do të shkojmë ne në Europë? Ndër pesë kritere, keni dështuar tek të pesta.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju jeni pengesa e vetme që Shqipëria të futet në Europë. Ju jeni.

Më 26 maj, të gjithë qytetarët, të majtë e të djathtë, pa bindje politike, duhet të dalin te sheshi për t'ju hequr ju si pengesën kryesore drejt rrugës së integritit.

Faleminderit!

Genc Pollo – Zoti Spaho e ka fjalën. Më pas do të flasë zonja Spiropali.

Edmond Spaho – Çështja e integritit është shumë e rëndësishme. Ne kemi vetëm 30 ditë në dispozicion para se të merret vendimi nga Komisioni European nëse do të hapen negociatat për Shqipërinë apo nuk do të hapen.

Sikurse është thënë me dhjetëra herë nga shtetet anëtare të Bashkimit European, edhe institucionet e Brukselit, hapja e negociatave është mbi bazën e meritës, që do të thotë mbi bazën e reformave që ka kryer vendi, nuk është çështje rezolute. Rezoluta që ju kërkon të miratohet nga Kuvendi nuk ka asnjë vlerë në vendimmarrjen e Komisionit European dhe të vendeve anëtare, sepse do të shikojnë reformat. Kjo është një rezolutë e përgatitur për konsum të brendshëm, për synime të brendshme. Ajo, në vendimmarrjen që do të merret në fund të qershorit nuk do të japë asnjë efekt, sepse vendet anëtare do të na gjykojnë mbi bazën e reformave. Në të gjitha takimet që ne kemi pasur deri tani me komunitetin ndërkombëtar, veçanërisht në këta 4-5 muajt e fundit, është thënë qartë: “Shqipëria duhet të japë rezultate të prekshme, të kapshme, të ndjeshme dhe të forta në luftën kundër krimit të organizuar”. Gjithashtu, ata kanë kërkuar kapjen e peshqve të mëdhenj. Kësaj kërkesë të komunitetit ndërkombëtar ne duhet t'i përgjigjemi me veprime dhe me aksione konkrete, jo me rezoluta.

Hajdeni të shkruajmë çfarë të doni në letër, që do të angazhohemi për të luftuar krimin e organizuar, që do të bëjmë përpjekje e të tjerë, por kjo nuk vlen, sepse ata duan veprime, duan aksion.

Kjo maxhorancë ka një histori të gjatë në lidhje me krimin e organizuar dhe mos kujtoni se ata kanë harruar. Prandaj ata insistojnë që të shikojnë prova, që kjo qeveri po jep shenja, po bën veprime dhe se po ndryshon sjellje. Nuk është e nevojshme që të kujtoj historinë e kriminalizimit në Kuvend dhe faktin që jemi i vetmi shtet në Europë që kemi një ligj për dekriminalizimin të superstrukturës, të pjesës më të rëndësishme të shtetit, që ta dekriminalizojmë. Deri këtu kemi arritur ne, sepse të njëjtën gjë kemi edhe për pushtetin vendor, të njëjtën gjë kemi edhe për policinë, të njëjtën gjë kemi edhe për qeverinë. Pra, ne jemi një shtet i kriminalizuar deri në palcë dhe ndërkombëtarët, partnerët tanë, vendet ku ne dëshirojmë që të integrohemi, na kërkojnë që t'u tregojmë me vepra se do të ndahemi nga kjo rrugë dhe nga kjo sjelle politike, por ne këtë gjë nuk po e bëjmë.

Me çfarë mund t'i shërbejmë ne integritet në 30 ditë? Nuk i shërbejmë me rezolutë. E mira do të ishte, për shembull, që qeveria ta kapte Balilajn, në mënyrë që të tregojë se po jep shenja duke kapur një eksponent të krimit të organizuar. Shenja e dytë do të ishte dorëheqja e ministrit të Brendshëm. Nuk mund t'u shkojmë ne vendeve të Bashkimit Europian me një ministër, i cili e ka vëllanë e tij në burg, të dënuar për krim organizatash kriminale dhe për trafik ndërkombëtar droge. Kjo nuk mund të ndodhë. A mund të më thoni një vend në Europë, anëtar i BE-së ose jo anëtarë i BE-së, që e ka ministrin e Brendshëm në këtë pozicion? Ju mos u merrni fare me përgjime, sepse ai është dënuar me 7 vjet në Itali për trafik droge.

Taulant Balla – A e hoqët përgjimin?

Edmond Spaho - Përgjimi aty është dhe do ta shikosh kokë e këmbë. Deri ditën e shtunë do të dalin të tjera përgjime, ku do të tregojmë me fakte se është ende i përfshirë në trafik droge dhe se si ju e keni mbrojtur.

Duroni Taulant, se do t'i shikoni! Vetëm fakti se e ka vëllanë në burg për trafik ndërkombëtar droge është i mjaftueshëm që ministri të japë dorëheqjen. Pse kështu do ta kërkojmë ne hapjen e negociatave?!

Tregohuni seriozë! Pse nuk paska kjo parti një njeri që të mos jetë i lidhur me krimin e organizuar për të bërë atë detyrë, por duhet të marrim në konsideratë interesat e këtij grupi kriminal, brenda maxhorancës, për të rrëzuar interesat e Shqipërisë?! Interesi i Shqipërisë është që të integrohemi. Ne kemi bërë shumë sakrifica këta 30 vjet, kurse ju tani doni t'i

hidhni poshtë vetëm për të mbrojtur interesat e një grupi kriminal brenda maxhorancës, në krye të të cilit është Kryeministri.

Ky zotëria, Taulant, që po e mbroni, Agroni, Gerondi, është koka e krimit të organizuar në Vlorë, i cili, edhe pasi ka ardhur nga Italia, është marrë me drogë edhe pas vitit 2013, kur ju erdhët në pushtet, ka vazhduar këtë aktivitet, edhe pas emërimit të të vëllait si ministër i Brendshëm është marrë me këtë aktivitet. Këtë fakt jua kemi treguar dhe do t'jua tregojmë përsëri, si edhe mbrojtjen që i keni dhënë. Por, nuk është ky argumenti, sepse mjafton që vëllanë e ka të dënuar për trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike, që ministri të mos jetë në qeveri, pa folur për këto të tjerat. Për këto të tjerat ai do të jetë subjekt i ligjit dhe do të japë llogari kur të hetohet. Kështu që tregohuni seriozë dhe reflektoni, sepse edhe një muaj na ka mbetur.

Genc Pollo – Faleminderit, zoti Spaho!

Në fakt, pyetja juaj është edhe pyetje e shumë shqiptarëve, të majtë dhe të djathtë: a nuk është në gjendje Partia Socialiste që të gjejë një person pa lidhje kriminale për postin e rëndësishëm, siç ai i ministrit të Brendshëm? Kjo është një pyetje që meriton debat, ndoshta është edhe pritshmëria ime për të marrë një përgjigje nga diskutimet që do të kemi sot në komision.

Fjalën e ka zonja Spiropali.

Më pas fjala për zotin Ulqini.

Elisa Spiropali - Kur pashë kolegët e opozitës që mësynë në këtë sallë nëpërmjet asaj dere, mendova se ndoshta emrin e partisë duhet ta ndryshoni dhe ta bëni GAT, Garnizoni për Aksion në Terren, ose UTOPIA, Ushtria e Trupave pa Ide dhe pa Atdhe, të zgjidhni kryetar Babalen, si zëvendëskryetar të zgjidhni Jetmir Olldashin, Lulin ta çoni në pension kurse president nderi keni babën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Epo një burrë, kryetar i Grupit Parlamentar, që mundohet t'i mbivendoset zërit të një gruaje nuk është parë dhe dëgjuar, është ku thërret qameti, zoti Spaho. Ti na bërë të lidhur me drogën.

A ka mundësi të vazhdoj?

Edmond Spaho – Po deshe të flasësh për çështjen!

Elisa Spiropali – Nuk ma caktoni ju se për çfarë duhet të flas. Ju po thoni që jemi të inkriminuar, e kuptoni sa rëndë jeni zhytur në gjirizet e krimit?!

Tani, për sa i përket çështjes aktuale, do të ishte më e ndershme për partinë tuaj, apo për opozitën e vendit dhe partinë tjetër, që të dalë dhe të mbajë një qëndrim në raport me

integrimin, i cili është i vërtetë. Të mos i marrë njerëzit për budallenj, të mos u thotë se kemi shkuar dyerve të Europës për të lobuar për integrimin, sepse po na del që të vetmit deputetë, që janë kundër integritit të Shqipërisë në këto vende, janë miqtë tuaj. Tani, kur nuk keni bindur as miqtë unë nuk e di se kë mund të bindni tjetër. Apo jo, zoti Strazimiri. Pra, ju duhet të dilni dhe të thoni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, a ka mundësi ta mbaroj?

Aldo Bumçi – “Plotësoni parakushtet”, tha Kancelarja Angela Merkel në konferencë shtypi.

Elisa Spiropali – Ju duhet të dilni e të thoni: për këto arsye, që ne i mendojmë të rëndësishme, ne jemi kundër integritit të Shqipërisë në BE. Por të dilni publikisht të thoni që po llojmë, pastaj të thoni “Çelini negociatat me Noriegën dhe me kokat e krimit që janë në maxhorancë”, kjo është e turpshme, sepse është e pabesueshme, është një mungesë totale racionaliteti në raportin tuaj me zgjedhësit. Të njëjtën gjë bëtë për reformën në drejtësi, Albana dhe po ju flas shumë sinqerisht.

Taulant Balla – Ju shihni ëndrra me sy hapur. Një ministër, 6 deputetë, 3 ish-ministra dhe 24 vetë. Budallaqet e Saliut dëgjon ti?

Elisa Spiropali – Do të ishit më të ndershëm po të mbanit një qëndrim të guximshëm në raport me këtë dhe të thoni se jeni kundër çeljes së negociatave për këto arsye, sepse besoni se ky vend i kriminalizuar nuk e meriton, por ju po e bëni njësoj siç e bëtë për reformën në drejtësi. Nga njëra anë thoshit që jeni pro reformës në drejtësi dhe nga ana tjetër nuk lini gur pa lëvizur dhe pengesë pa vënë në mënyrë që kjo reformë të mos gjejë zbatim. Pra, e votuat kokulur në atë konsensusin e famshëm të 140 votave, pastaj ngritët çadrën që të mos votonit vetingun, ngritët çadrën që reforma në drejtësi të mos gjente zbatim. Pra jeni hipokritë në të gjithë aksionin tuaj politik, prandaj po humbni nga 200 mijë vota çdo 4 vjet, sepse nëse ka diçka që njerëzit nuk e falin, është mungesa e vërtetësisë.

Për sa i përket çështjes së drejtësisë, ne e kemi deklaruar që nuk ndërhyjmë, por lëmë strukturat e drejtësisë që të bëjnë hetimet përkatëse dhe të dalin me një vendim. Nuk jemi si ju që i mbani në detyrë ata që ishin të arrestuar, besoj e mbani mend kur ishit në qeveri, por ama, për akuzat tuaja duhet të përgjigjeni, sepse ju nuk po kriminalizoni ministrin e Brendshëm, i cili nuk ka asnjë lidhje me faktin, nuk keni ende asnjë provë që ministri i Brendshëm nuk ka kryer detyrën e tij, ju doni të kriminalizoni një vend të tërë. Edhe këtu, në deklaratën e zotit Bumçi, dhe mua më vjen shumë keq, se ai ka qenë ministër i Jashtëm, përdoren terma si: krimi shqiptar ne Holandë, ndërkohë që faktet janë që krimi shqiptar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ju merrni deklaratat e një grupi të vogël dhe i sillni në tryezat e komisioneve parlamentare. E kuptoni sa rëndë jeni? Albanofobët jeni ju në këtë pjesë.

Aldo Bumçi – Mund të rivendoset regjimi i vizave prej krimit shqiptar, ka thënë Holanda.

Elisa Spiropali - Për sa u përket fakteve, Komisioni European ka deklaruar që ka një raport ku, për të 5 prioritetet, deklarohet e zeza mbi të bardhë që Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm, veçanërisht në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit të drogës. Lexojeni raportin e komisionit nga fillimi deri në fund dhe shini a ka progres apo jo! Nuk thotë që ka qëndrim në vend, pra jo regres, por progres në të gjitha prioritetet dhe ju dilni këtu dhe thoni që Komisioni European dhe BE-ja duhet të flasin me gjuhën tonë të nxirë. Pse, i ka lënë mendja ata? Në fakt, kur vijnë aty dhe bëjmë debatet tona, siç ajo e Komitetit të Stabilizim-Asociimit, ata lënë mend me deklaratat tuaja, madje disa herë zonja Makovei dhe të tjerë u detyruan t'u thoshin që t'u referoheshit fakteve, sepse ata nuk mund të mendojnë që opozita e një vendi flet me një gjuhë të tillë për vendin e vet.

Aldo Bumçi- Nuk përmendi drogën për 4 vjet

Elisa Spiropali- E paska fajin zonja Makovei. E ka fajin Kryetarja e Komitetit të Stabilizim-Asociimit që në Shqipëri nuk ka drogë. Atë po thoni ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aldo Bumçi- Nuk e përmendi, pra. Gjermanët thonë që ka drogë, italianët po ashtu, ndërsa ata nuk e përmendin. Nuk janë përfaqësues të BE-së.

Elisa Spiropali – Bëri një deklaratë zoti Junker për progres të jashtëzakonshëm të Shqipërisë, ndërsa ju çfarë nuk thatë për të, madje thatë që është pijanec. Të njëjtën gjë bëtë kur zonja Mogerini foli për progresin e Shqipërisë, ju e nxorët komuniste të lidhur me qarqet italiane. Më falni, të mos flasim pastaj se çfarë keni thënë për ambasadorin e BE-së dhe ambasadorin amerikan. Ju jeni kthyer në garnizon për aksionin në terren të verifikimit të biografisë së përfaqësuesve të BE-së.

Aldo, të lutem, mos na bëni bolori në sytë e atyre që na shohin, sepse jeni bërë për turp. E them sinjerisht, keni lodhur njerëzit, të cilët jo që nuk i shohin dot seancat parlamentare, sepse ju keni uzurpuar çdo hapësirë fizike, por edhe të diskutimit, por nuk ndjekin dot më as komisionet, sepse ju jeni bërë si cirk shëtitës nga komisioni në komision, vini dhe jepni shfaqje të huaja. Të paktën anëtarët e komisionit, ata që janë të flasin, por ju gjezdisni në çdo komision dhe thoni të njëjtat gjëra pa asnjë fije origjinaliteti ose fakti. Kjo është shumë e rëndë.

Tani t'u kthehemi çështjeve në komision. Kemi një muaj e më pak kohë të bëhemi bashkë për çështjen e integritetit dhe pastaj të vazhdojmë luftën tonë politike. Ju shërben edhe juve çelja e negociatave, detyrat e shtëpisë janë bërë. A ka nevojë më shumë në fazat e tjera? Pa diskutim që Shqipëria ka nevojë të bëjë më shumë në të gjitha prioritetet, por në fazën që jemi Shqipëria nuk është pas vendeve të tjera të rajonit, përkundrazi, sa i përket reformës në drejtësi është një hap para. Na lini të punojmë! Hajdeni së bashku të përmirësojmë ato që mundemi! Shqipëria e meriton të hapen negociatat, prandaj mos u vini përpara si barrikadë në këtë rrugë.

Genc Pollo- Faleminderit, zonja Spiropali, por përgjigjen e pyetjes së zotit Spaho: A nuk është në gjendje Partia Socialiste të emërojë në postin e ministrit të Brendshëm njeri pa lidhje personale apo familjare, nuk e morëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elisa Spiropali- Do të marrë borxh ato që kishte kryeministri juaj.

Genc Pollo - Nuk e dëgjuam përgjigjen e pyetjes, është përgjigje me interes.

Zonja Tabaku kishte diçka për procedurë.

Jorida Tabaku- Unë kam vetëm një koment, meqenëse ju drejtuat, zotit Bumçi.

Së pari, zonja Spiropali, kur flisni për Partinë Demokratike, duhet të keni një farë etike.

Elisa Spiropali -Po ju thoni që ne jemi të kriminalizuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Jorida Tabaku— Kjo është një parodi e madhe , nuk di çfarë të bësh, të qash apo të qeshësh. Ju keni 10 deputetë të prekur nga dekriminalizimi dhe flisni për Partinë Demokratike.

Elisa Spiropali - Ju thoshit që zbritën alienët dhe ndërruan kutitë, por fakti është që humbët zgjedhjet.

JoridaTabaku - Unë i dëgjoj me vëmendje të gjithë kolegët, kam vetëm një replikë, 55% në fshatin e Moisi Habilajt në vitin 2013, 86 % në vitin 2017...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku- Një koment për faktin e albanofobisë. Deputetët holandezë na thanë se nuk ka ardhur asnjë raport nga opozita. Kanë ardhur raporte në Amsterdam dhe Rotterdam nga shërbimet e policisë holandeze për krimin e organizuar nga Shqipëria, por asnjë fjalë nga opozita. Ishim bashkë atje, zoti Pollo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Genc Pollo- Fjalën e ka zoti Ulqini.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elisa Spiropali - unë jam anëtare e këtij komisioni, zonjë! Nuk vij vërdallë!

(Diskutim pa mikrofon)

Musa Ulqini – Faleminderit, kryetar!

Si anëtar i këtij komisioni, dua të shpreh një opinion timin lidhur me çfarë po ndodh muajt e fundit.

Nuk kam asnjë thirrje e as lutje për askënd, nuk kam asnjë koment se si po shkelen apo po respektohen procedurat e rendit të ditës, por, në respekt të 24 vjetëve në Kuvend, dua të sjell në vëmendjen tuaj tri-katër gjëra: në vitet e para, thelbi i diskursit të Partisë Demokratike ka qenë antikomunizmi, gjë që u elaborua në mënyrë të jashtëzakonshme, edhe pse në krye të asaj partie ishte një nga simbolet e komunizmit.

Në vitet 2000, thelbi i gjithë diskursit të Partisë Demokratike ishte korrupsioni, edhe pse në gjoksin e saj kishte shumë medalje që dëshmonin të kundërtën.

Sot, thelbi i diskursit tuaj është droga, edhe pse Lazarati është një gjë që nuk zhbëhet as sot, as nesër, dhe nuk nderon as opozitën, as pozitën dhe as Shqipërinë.

Ditën që u publikua raporti i BE-së, kam menduar se më në fund erdhi momenti që të gjithë ne të sillemi në mënyrë serioze, në një moment shumë serioz dhe historik për Shqipërinë. Kështu e kam quajtur në një koment të rrjeteve sociale, sepse 28 qershori është një moment që lidhet me fatin e çdo studenti shqiptar që është jashtë, apo çdo gjimnazisti që do të shkojë jashtë për studime, çdo të sëmuri që do të marrë ndihmë mjekësore, çdo njeriu që do të punojë atje, çdo biznesmeni që do të lidhet me bizneset atje si dhe çdo shqiptari që ka punuar andej dhe do të kthehet këtu, pasi, paratë që ka fituar, atë përvojë, ato lidhje, t'i sjellë në të mira në vendin e vetë. Një e mirë e madhe edhe për opozitën, sepse është një mundësi e madhe, që duke qenë pjesë e këtij procesi, të ketë një kontroll më të madh për çdo të mirë apo të keqe që bëjmë të gjithë ne.

Kam menduar që është momenti ku forcat politike mund të respektojnë traditën më të mirë të shqiptarëve ndër shekuj, që kur i sulmonte dikush nga jashtë, akti i parë, të paktën andej nga vij unë, ishte që të falnin gjakun dhe të bashkoheshin.

Bardh Spahia - Po kush na ka sulmuar, Musa?

Musa Ulqini – Duke qenë deputet, jam habitur që, për herë të parë në jetën time, të lexoja një raport kaq të mirë dhe pa kushte për Shqipërinë. Vepër jo e një individi të vetëm, qoftë ky edhe kryeministër, jo e një maxhorancë, qoftë kjo Partia Socialiste, por një kontribut ndër vite, me luftëra e keqkuptime, me të mirat dhe të metat e politikës shqiptare.

Kur shkon në një moshë si imja, fillon të gjykosh ndryshe për çështjen. Jam gëzuar pafund dhe kam menduar që të gjithë do të mbajmë një qëndrim serioz me raportin më serioz që ka publikuar ndonjëherë dikush për ne. As raporti i Institutit Republikan Amerikan për zgjedhjet e 22 marsit, nuk ka qenë kaq pozitiv sa ky raport për Shqipërinë!

Dua ta shpreh shumë qartë, që nuk e kisha pritur, nuk e kam besuar dhe nuk dua ta besoj mënyrën si e perceptoi, si e asimiloi dhe si po reagon opozita për këtë raport kaq pozitiv, i cili ka qenë kontribut i të gjithëve! Kam menduar që çdo opozitë apo maxhorancë ka të drejtë të mësojë nga gabimet e të tjerëve. Edhe kjo opozitë, që sot është në maxhorancë, ka bërë gabime lidhur me këto gjëra në të kaluarën. Kam menduar që gjërat vijnë duke u përmirësuar. Darvini thoshte: “Raca vjen duke u përmirësuar!”, historia kështu ka dëshmuar. Nuk kam menduar që opozita e sotme do ta përkeqësonte sjelljen e saj duke tejkaluar në mënyrën më drastike çdo lloj opozite, edhe opozitën e vitit 1920.

Si ka mundësi që sa herë afrohet data 28, aq më shumë, në çdo element, në selinë e Partisë Demokratike, në komisione, në daljet publike, në televizione, në takime më të huajt, në shtëpi kur jeni vetëm, prodhoni një gjë që është absolutisht, jo në dëm të qeverisë, por në dëm të të gjithë shqiptarëve! Ka një shumicë të madhe, që është përtej nesh, që e pret këtë gjë. Si mund të ndodhë të përsëritet në mënyrë shumë dramatike, ajo që ndodhi me firmat piramidale! Shqipëria u dogj nga këto firma, kjo që po ndodh tani, djeg të ardhmen e të gjithë shqiptarëve, sepse jo të gjithë njerëzit e shikojnë të ardhmen duke ikur në Europë, por duke e ndërtuar këtu Europën.

Hapja e negociatave është një gjë e jashtëzakonshme. Kam pasur fatin të shkoj në Irlandë dhe atje kam mësuar dhe kam prekur me dorë një realitet: ndryshimi i Irlandës ishte i jashtëzakonshëm që nga dita kur u hapën negociatat, deri ditën që u bë pjesë e BE-së. Po çfarë ndodh te ne?! Si ka mundësi që edhe një kasetë,

që është bërë në tetor, duhet përdorur tani?! A nuk ka mundësi, që kjo opozitë, edhe gjërat e këqija, që nuk janë pak në vendin tonë, t’i marrë e të shkojë t’i thotë Kryeministrit – “Këto gjëra në datën 28 do t’i bëjmë publike”, sepse është një e mirë e madhe e të gjithë shqiptarëve që këto ditë të mbajmë gojën, këto ditë të themi ato gjëra që na bashkojnë. Si ka mundësi? Ka kaq shumë gjëra që ndodhin për të cilat nuk dua t’u besoj veshëve, procedura, jo u shkel kjo e jo ajo, por të gjitha janë fare kot, sepse është shkelur thelbi negativ...

Albana Vokshi – Pse nuk e ke thënë? Pse nuk e keni bërë për 3 ligjet, të cilat i keni bllokuar nuk e di se për sa vjet...?

Musa Ulqini – E thashë këtë...

Albana Vokshi – Në qarkun e Fierit kush e bëri...

Musa Ulqini – Si ka mundësi?

(Diskutime pa mikrofon)

Albana Vokshi – Çfarë po flisni tani?

(Diskutime pa mikrofon)

Musa Ulqini – Ju lutem, më respektoni edhe për dy fjali!

Siç edhe jua thashë në fillim, si ka mundësi që ato gjëra të këqija që ka bërë opozita ju nuk i hidhni në koshin e plehrave, por doni të bëni akoma edhe më keq?

Aldo Bumçi – Të flasësh për drogën është gjë e keqe?

Musa Ulqini – Tani po ju them dy gjëra që lidhen...

Aldo Bumçi – Çfarë është europiane, ta luftosh apo ta mbrosh drogën?

Musa Ulqini – Të lutem, dy fjali kam, pasi unë flas shumë rrallë!

Unë një jetë të tërë jam marrë me mitingje dhe kur ju pashë atë ditë në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, ku erdhët të gjithë, përjetova një gjë të çuditshme, mendova se ato antimitingjet që bëheshin dikur në '92-in i takonin historisë. I kam mirëkuptuar të gjithë ata që vinin dhe i prishnin mitingjet, 15 apo 20 veta, sepse ashtu ishte koha, nuk kishte kulturë politike, kishte keqkuptime historike dhe kjo ishte diçka normale për atë kohë, por jo tani, sepse tani kemi një vizion dhe një pjekuri tjetër, unë dhe secili prej jush...

(Diskutime pa mikrofon)

.... por që të vinte koha që ato antimitingje të ktheheshin në një mënyrë kaq përkeqësuese në kundërshtim me gjithë mënyrën se si funksionon në thelb parlamenti, parlamentarizmi dhe komisionet, kjo është diçka që më ka bërë përshtypje dhe nuk do ta harroj kurrë. Unë nuk do të bëj libër me kujtime, por po ta bëja do të ishte një kapitull.

Në fund fare, ju mirëkuptoj dhe keni të drejtë të më suleni, por do t'jua them edhe një fjalë: nuk ka dhimbje më të madhe koke për ata që organizojnë mitingjet sesa përpjekja për të sjellë sa më shumë njerëz dhe këtë e di shumë mirë, sepse kam bërë 75 mitingje në Tiranë. Por nuk e di që ndonjëherë PD-ja, PR-ja dhe partitë që nuk janë më, ose LSI-ja dhe PS-ja të jenë përpjekur për të përdorur një Babale për të mësuar njerëzit për të ardhur nëpër mitingje. Ka shumë gjëra të tjera serioze për këtë vend që mund të jenë frymëzim, ne kemi përdorur arrestimin e Nanos, të tjerët kanë përdorur gjëra të tjera, sot mund të thoni çfarë të keni dëshirë për mua, sepse gjërat nuk harrohen, siç kujtohet 22 marsi, e famshmja rrahje në sheshin “Skënderbej” e 26 majit, siç kujtohen gjërat e mira apo të këqija që ka bërë PS-ja, të gjitha kujtohen...

(Diskutime pa mikrofon)

Edhe 2 prilli pa diskutim, por ...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, nuk fillohet me 2 prillin, të lutem, por të vini dhe të ketë si simbol opozita e vendit tim pas kaq vitesh, ose përpiqeni të përdorni si frymëzim për të bërë një miting 5 ditë përpara se të hapen negociatat një gjë kaq qesharake, shpreh keqardhjen më të madhe që jeni sot të pranishëm këtu dhe pjesa më e madhe juaja nuk janë anëtarë të komisionit, diskursi i opozitës ka rënë në këtë derexhe.

Faleminderit që më dëgjuat!

Jeni të lirë të bëni çfarëdolloj dokumentesh, nuk kam asgjë me askënd, por jam i shqetësuar për atë që po i ndodh Shqipërisë.

Albana Vokshi – Po ju zbërthen skemën Babalja...

Genc Pollo – Faleminderit, zoti Ulqini!

Besoje se për mua dhe për ju mbetet shumë serioze pyetja e zotit Spaho, e cila nuk mori përgjigje: pse PS-ja kur një socialist ka lidhje me krimin nuk e heq dot nga një post i rëndësishëm si ai i ministrit të Brendshëm.

Elisa Spiropali – Sepse ministri aktual i Brendshëm nuk është i lidhur me krimin, përgjigjja është shumë e thjeshtë.

Genc Pollo – Fjalën e ka zoti Balliu.

Klevis Balliu – Faleminderit, zoti kryetar!

Është e vërtetë ajo që tha Elisa, që kemi shkuar në çdo komision, duke bërë një pyetje: a gjeni dot një person tjetër në Partinë Socialiste që ta bëni ministër të Brendshëm? Sot e kësaj dite, pavarësisht se shkojmë, siç tha edhe Elisa në çdo komision nuk na kthen njeri përgjigje. Arsyeja pse, është se asnjë deputet i maxhorancës nuk e thotë dot që Rilindja drogën e ka kriter për të ecur përpara, nuk e ka problem dhe kjo është diçka që nuk ndodh vetëm tani, meqë ju referuam historive të partive, dua t'ju kujtoj që nga partitë e mëdha këtu vetëm deputeti i një partie ka plagosur një deputet tjetër (kur u plagos Azem Hajdari në parlament) dhe ai është deputeti i kësaj partie që ju jeni sot këtu.

Pastaj, për sa u përket akuzave që ka ngritur zoti Balla, drejt Partisë Demokratike se është marrë drogë, kjo është njësoj sikur të akuzojë Adolf Hitleri Martin Luter Kingun për racizëm. Ta akuzoni ju për drogë Partinë Demokratike! Unë vetëm këtu kam parë që 613 kilogramë drogë mund t'i lëvizka opozita, nuk e kam parë në ndonjë vend tjetër.

(Diskutime pa mikrofon)

Për sa i përket çështjes së Fatmir Xhafajt nuk e di dhe nuk mund të them që Fatmir Xhafaj ka lidhje me drogën, sepse nuk e di dhe nuk e kam këtë informacion, por që Agron

Xhafaj ka lidhje me drogën këtë e them, sepse nuk e ka arrestuar as qeveria e Sali Berishës dhe as ndonjë qeveri tjetër, por e kanë kapur italianët. Në qoftë se ndonjëri prej jush këtu mendon se është fare normale të kemi një ministër të Brendshëm, vëllai i të cilit është dënuar për narkotrafik, jo me hashash dhe duke shitur dy qese, por me kokainë dhe heroinë, drogë e niveleve të larta, me trafik ndërkombëtar. Ju qofshi, ta mbani ju atë përgjegjësi!

Në qoftë se ministri i Brendshëm paska të drejtë t'i thotë në formularët e vetingut, atij policit që merr 500 mijë lekë në muaj: a ke pasur ti ndonjë lidhje, a ke folur ndonjëherë, a je takuar ndonjëherë me ndonjë person që mund të ketë pasur lidhje me krimin e organizuar? E nëse ai e ka pasur këtë lidhje, ai nuk bëhet dot polic, ndërkohë që ministri i Brendshëm ka vëllanë.

Tani ne jemi shqiptarë, mund të kemi shumë gjëra, për të cilët mbase në Europë na e kalojnë: mund të jenë shoqëri më demokratike, më e zhvilluar, por ne kemi një gjë, që nuk e ka askush tjetër si ne, dhe është respekti për familjen. Për familjen shqiptari bën gjithçka. Askush nga ju nuk mund të më thotë mua, se po t'i jepet rasti Fatmir Xhafajt, nuk do ta mbrojë vëllanë e vet. Se këtu lindin këto probleme. Ne jemi shqiptarë, kemi mbajtur ligje; shqiptarët kanë emigruar për të mbrojtur familjet e tyre. E ju do të më thoni mua se ky zotëri nuk do ta mbrojë vëllanë e vet, por do ta futka në burg?!

Për sa i përket përgjimit, ju thoni se Babalja është narkotrafikant, është kështu e është ashtu. Jua thashë edhe qëparë: Me kë prisnit ju të fliste në telefon Agron Xhafaj? Me Babalen do të fliste, sepse me Babalen rrinte ai, me narkotrafikantë rrinte ai. Nuk do të fliste me deputetë të Holandës, nuk do të fliste as me shkrimtarë, as me intelektualë, por me narkotrafikantë do të fliste.

Të gjitha familjet mafioze u kapën, Xhon Goti me Sammy Gravanon, Toto Riina me Bushetën, me narkotrafikantë u kapën, se me ata flisnin. Kjo është bota dhe jeta që i qarkullon.

Sot do të ishte në dinjitetin e Fatmir Xhafajt, por edhe në dinjitetin e secilit prej jush, të thoshit: prit, more zotëri, se kemi njerëz të tjerë këtu, të cilët mund të na e bëjnë këtë punë, që të mos na drejtojnë gishtin. Aq më tepër, kur keni një Sajmir Tahiri, një person që i inkriminoi institucionet e Policisë së Shtetit, një person që kanabizoi një vend të tërë, i cili sot është në arrest shtëpie. Deri dje këto fjalë që po thoni sot në mbrojtje të Fatmir Xhafajt, i keni thënë edhe për Sajmir Tahirin. Këtu keni ngecur ju.

Tashti, në qoftë se doni të bëheni seriozë, i thoni atij të gjatit, që të fillojë të marrë përgjegjësi.

Në mbyllje, për Taulantin këtë: Taulant, jam totalisht koshient se keni një dhjetë-pesëmbëdhjetë ditë që po mundoheni të kontaktoni me Fahriun, por as nuk e keni takuar e as keni për ta takuar ndonjëherë, se ne nuk bëjmë dot kompromis me drogën. Kështu që, edhe atij të gjatit mund t'ia thuash këtë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Velaj – Ajo që unë mbaj më shumë mend nga fjalët e zotit Spaho, ishte kur tha se deri të shtunën do të shikojmë filma të tjerë. Pra, telenovela vazhdon, skllavja Izaura do të bëjë për të qarë të gjithë spektatorët. Lucélia Santos, aktorja, do të ulërijë nga dhimbjet. Në fund fare do të presim telenovelën tjetër, e cila do të vazhdojë deri muajin tjetër.

Ju ndërtuat kullën e Babales, duke e shfletuar Biblën, dhe e barazuat atë me Kullën e Babelit. Nga Bibla e morët vesh se kur Perëndia pa që njerëzit poshtë ishin të shthurur, e prishi Kullën e Babelit dhe i la gjithnjë e më poshtë.

Kështu ishte edhe historia e Babales. Unë që vi nga Vlora dhe e njoh fare mirë këtë histori. Pyeta se kush është ky person, dhe më thanë: “është një lyrash. Shyqyr që iku, se vinte tavolinë më tavolinë, bënte sikur kishte një hall, dhe thoshte: më jep dhjetë mijë lekë, se ashtu e kam punën. Pastaj shkonte në tavolinën tjetër”.

Ky ishte ai zotëria. Pra, ju gjetët njeriun me probleme nga më të mëdhatë, në një krizë të madhe identiteti, ndërsa tani mundoheni që të gjithë Vlorën ta bëni Babalërinë tuaj. E gjithë Vlora e di fare mirë. Kjo ishte arsyeja që Vlora u shpërngul nga ju, dhe ju tha se ne nuk jemi as Babalja, dhe Babica e Vogël nuk janë Habilajt.

Për sa i përket ministrit, unë po ju them diçka. Meqenëse iku edhe personi që i mbante lidhjet me Francën, sepse kështu tha: takoi Makronin. Ministri kishte takuar edhe Gérard Collomb, para ca kohësh, i cili i tha vlerësimet më të larta. Po meqë edhe ju, zoti Pollo dhe ish-kryetari grupit të miqësisë me Austrinë, e dini fare mirë se ministri takoi (*s’degjohet*), besoj se ta tha miku ynë i përbashkët në Vjenë dhe miku juaj i atëhershëm, i cili i tha vlerësimet më të larta në lidhje me punën që ka bërë dhe luftën që i ka shpallur krimit.

Por, vlerësimi më i madh ka ardhur nga Herbert Kickl, i cili është ministër i Brendshëm i Austrisë dhe vjen nga ekstremi i djathtë i partisë së Jörg Haider, i cili i tha, e ju e dini fare mirë, se ne e mbështesim luftën që ju i keni shpallur krimit dhe të gjitha përpjekjet që keni bërë për integrimin evropian të Shqipërisë.

Pra, këta dy zotërinj, të cilët vijnë nga kampi i djathtë, vlerësojnë përpjekjet e ministrit të Brendshëm dhe kë të besojmë tani, të besojmë “Babalen”, apo të besojmë ata që i kam miq unë, i keni miq ju, i keni miq edhe atje tutje? Prandaj jam i bindur se Fatmir Xhafaj

ishte personi i duhur, në momentin e duhur, do të japë goditjen përfundimtare. Të mos presim të shtunën, serinë e fundit të Izaurës, por të presim hapat që do të vijnë në luftën ndaj krimit, siç ishte ajo me 630 kilogramë, apo në të tjerat që do të vijnë me mbrapa. Kaq kisha për të thënë.

Genc Pollo - Faleminderit!

Me gjithë respektin e duhur, përsëri konstatoj se zoti Spaho për pyetjen nuk e mori përgjigjen. Shpresa vdes e fundit!

Po, zoti Strazimiri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Velaj - Ju e gjetët “Babalen” si “*Babonatale*” dhe menduat se do t’ju sillte dhurata!

Gent Strazimiri - Ky vend...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky vend edhe sikur të kishim mbyllur gojën ne, Agroni të mos ishte, “Babalja” të ishte ky që thua ti, Agroni të ishte ai i larti që ka një gabim në adoleshencë gjendur në vendin e gabuar, në momentin e gabuar...

(Zoti Gent Strazimiri flet pa mikrofon)

...613 kilogramë kokainë, nën këtë qeveri që kontrollon territorin dhe lufton krimin e organizuar, është i gatshëm për të hyrë në Europë, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elisa Spiropali - Fakti është që u kap.

Gent Strazimiri – Ky vend është i gatshëm apo jo? E kontrollon vendin ky ministër apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky vend është vend europian?

Elisa Spiropali - Po, duroni sa të dalë rezultati i hetimeve.

Gent Strazimiri - A është ky një vend i gatshëm për në Europë?

Elisa Spiropali - E di pse e konsideroni si humbje kohe ju, zoti Strazimiri, sepse ju doni që Partia Demokratike të ketë strategji të vërtetë, të thotë: “Nuk e meriton Shqipëria çeljen e negociatave”, apo jo? Për çfarë po e bëni estradën me integrimin?

Burrë - E vërteta sipas koncertit tuaj.

Gent Strazimiri- “Miq një lajm i trishtuar na ka shokuar të gjithëve në PS. Natën e kaluar gruaja shtatzënë e kryetarit të sapozgjedhur të bashkisë Kavajë, Elvis Roshi, u rrëmbye në një qendër tregtare në Tiranë. Pasi është keqtrajtuar barbarisht nga rrëmbyesit,

ajo është dërguar në një vend të panjohur, ku i kanë hequr fëmijën. Në orën 4 të mëngjesit...

Elisa Spiropali - E kemi lexuar.

Zoti Strazimiri, nuk e kuptoj sesi kusuret tona ju i keni 100 fishuar. Nga opozita në pozitë...

(Zoti Strazimiri flet pa mikrofon)

Gent Strazimiri- “Fituam Kavajën për herë të parë më 8 maj dhe kjo është konsideruar si fitore simbolike e këtyre zgjedhjeve. Gjatë fushatës elektorale, zoti Roshi (ai i pastri) dhe shtabi i tij kanë marrë kërcënime...

Elisa Spiropali - Zoti Strazimiri, je apo jo që Shqipërisë t’i çelen negociatat?

(Zoti Gent Strazimiri flet pa mikrofon)

Gent Strazimiri – “Zoti Rama do të lëshojë një deklaratë për shtyp pas një ore... Duke pasur parasysh rrethanat shumë të rënda të situatës në Kavajë... Faleminderit! Erioni”.

Elisa Spiropali – Nuk ju përgjigje pyetjes: je apo jo që Shqipërisë t’i çelen negociatat?

(Zoti Gent Strazimiri flet pa mikrofon)

Thoni që nuk jeni dakord.

Përgjigjuni pyetjes!

(Zoti Gent Strazimiri flet pa mikrofon)

Gent Strazimiri –Largohuni se jeni të pafytyrë!

Mirupafshim! Gjithë të mirat!

Elisa Spiropali - Jeni apo jo për çeljen e negociatave?

Genc Pollo - A jeni dakord me kalendarin, siç është propozuar? Kush është pro? Kundër? Abstenim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbyllim, se nuk kemi as kuorumin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë ndryshimi keni?

Taulant Balla - Kjo është nesër në seancë.

Genc Pollo- Ta shtyjme.

(Incizimi shumë i dobët)

Dakord, pa projektraport..... çështja të diskutohet në Këshillin e Ministrave.

Biem dakord që miratohet apo te hapim procedura të tjera? Dakord.

Atëherë, mbledhja mbyllet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA